



Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)



HARTA BUJQËSORE



* FIER * TIRANË * ELBASAN * LUSHNJE * BERAT * DURRËS



Të përgjithshme

Qarku Fierit është një nga rajonet më të mëdha prodhuese të lakrës sallatë në fushë dhe në serra në Shqipëri me rreth 35% të prodhimit kombëtar.

Fruta e lakrës përmban: ujë rreth 94 %, L.Th. 8 %, proteina, 1.2 %, celulozë 1 %, lëndë minerale 1 %, 3.29 % lëndë eksraktive, yndyrna 2.29 % e tjerë.

Lakra është mjaft e pasur në vitaminën C në vlerat 60 - 70 miligram, vitaminë C në 100 gr masë të freskët, 0.3 miligram vitaminë A. Gjithashtu lakra është e pasur me kripëra minerale si Ca, Ka, Na, S etj.



PRODHIMTARIA DHE EKSPORTET E LAKRËS 2020-2021

LAKRA SALLATË

Origjina e lakrës konsiderohet Europa Perëndimore dhe vendet që ndodhen në brigjet e Mesdheut. Në këtë zonë edhe sot e kësaj dite gjenden një numër i konsiderueshëm i llojeve të egra.

Përlllogaritet që në vëndin tonë mund të kultivohen mbi 2000 ha nga ku një sasi të konsiderueshme e zë Ultësira Perëndimore, pasi kushtet tokësore dhe ekologjike të kësaj zone janë shumë të përshtatshme për këtë bimë.

Lakra sallatë kultivohet në dy forma: i) në serra, ii) në fushë të hapur. Prodhimtarinë më të lartë lakra sallatë e arrin në serra.

Sipërfaqe e kultivuar me perime gjithsej, 2013-2019 (ha)						
Nr	Qarku	2013	2015	2016	2018	2019
1	Berat	2,316	2,481	2,689	2,824	2,969
2	Diber	1,670	1,506	1,584	1,660	1,699
3	Durres	3,782	3,713	3,590	3,763	3,710
4	Elbasan	2,955	2,998	3,176	3,057	3,035
5	Fier	8,443	8,636	9,310	9,298	10,481
6	Gjirokaster	888	942	918	1,095	1,154
7	Korce	2,507	2,853	2,859	3,026	3,105
8	Kukes	706	662	697	705	747
9	Lezhe	2,000	1,755	1,920	2,044	2,057
10	Shkoder	3,958	3,773	3,949	3,754	3,771
11	Tirane	5,590	5,907	6,047	6,053	6,148
12	Vlore	1,957	1,942	2,062	2,189	2,564
Gjithsej		36,771	37,168	38,803	39,468	41,440

Nga kjo sipërfaqe serrash, rreth 400 ha kultivohen me lakër sallatë.

Sipërfaqe me perime të para në serra, 2015-2019 (ha)						
Nr	Qarku	2015	2016	2017	2018	2019
1	Berat	394	436	478	483	540
2	Diber	2	3	2	1	5
3	Durres	57	49	56	89	84
4	Elbasan	98	114	117	119	133
5	Fier	523	609	668	737	773
6	Gjirokaster	4	2	2	2	1
7	Korce	-	-	2	2	-
8	Kukes	1	1	1	1	1
9	Lezhe	7	8	10	10	9
10	Shkoder	75	99	115	113	96
11	Tirane	57	61	64	67	68
12	Vlore	26	24	26	26	24
Gjithsej		1,244	1,406	1,540	1,650	1,734

RËNDËSIA, VLERA EKONOMIKE DHE EKPORTI I LAKRËS SALLATË

Kultivimi i lakrës si për nga sipërfaqet ashtu edhe për nga rëndësia ekonomike, është një ndër bimët kryesore perimore që eksportohet nga Shqipëria. Kultivohet në periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga pranvera e hershme deri në vjeshtën e vonshme.



Sipërfaqja dhe prodhimi i lakrës në Shqipëri (2016-2019)

Përshkrimi	Viti 2016		Viti 2017		Viti 2018		Viti 2019	
	Sip. Ha	Prodhimi ton	Sip. Ha	Prodhimi ton	Sip. Ha	Prodhimi ton	Sip. Ha	Prodhimi ton
Lakra	1,846	55,655	1,813	52,600	1,733	52,857	2,023	70,411

Sipërfaqja e mbjellë me lakër paraqitet me një rritje prej 15% në krahasim me vitin 2018. Kjo si pasojë e rritjes së sipërfaqeve me serra diellore dhe përmirësimin e teknologjisë së kultivimit. Kryesisht dy varietetet më të kultivuara dhe me kërkesë të tregut të eksportit janë Keving dhe Nazomi. Tregu i eksportit ka një kërkesë të lartë për lakrën e sezonit dimëror, dhe kryesisht janë vendet me klimë të ftohtë si Ukraina, Polonia, Lituania.

Eksportet e lakrës dhe brokollit nga Shqipëria (2016-2020)

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
	Vlera (USD)	Vlera (USD)	Vlera (USD)	Vlera (USD)	Vlera (USD)
Lakra (përfshirë brokoli)	2,160,647	2,164,372	1,865,385	3,711,375	5,635,581

Nga të dhënat e siguruar nëpërmjet intervistimeve të 8 (tetë) kompanive më të mëdha eksportuese, për vitin 2020 dhe deri në muajin Prill 2021 janë eksportuar afërsisht rreth 10,000 ton lakër sallatë, kryesisht e prodhuar në serrat diellore.

Karta teknologjike e kultivimit të lakrës sallatë në serra:

Lakra sallatë prodhimtarinë më të lartë kryesisht e ka nga kultivimi në serra, nga ku sigurohen rendimente të larta, rreth 45 ton/ha, si dhe në përputhje të ciklit prodhues me kërkesën e tregut të eksportit.

Shpenzimet totale të ndara sipas zërave	Vlera në lekë/ha
Punime të mekanizuara	95,000
Punime me krahë	183,000
Inpute dhe materiale	551,500
Shpenzime të tjera	125,200
Totali i shpenzimeve	954,700

> Cmimet e shitjes për eksport gjatë periudhës Nëntor 2020 – Prill 2021, ka variuar nga 55-70 lek/kg, mesatarisht rreth 60-65lek/kg. Pra, ekonomikisht është siguruar një vlerë financiare e gjeneruar nga eksporti me rreth 6-7 milion Euro. Në total, sëbashku me tregun vendas parashikohet një vlerë financiare e gjenerur prej rreth 8-9 milion Euro.

Investimi i prezantuar mbështetet lehtësisht nga programi i granteve IPARD dhe fondi i garancisë së BERZH-it dhe Qeverisë Shqiptare-AASF. Financimi i investimeve mund të përfshihet nën programin AASF, duke i ofruar kështu mundësinë bizneseve të përfitojnë nga kushtet lehtësuese të ofruara nga Institucionet Financiare Partnere të programit: ProCredit Bank, IntesaSanpaolo Bank, OTP Bank, Raiffeisen Bank.

Kontakte:

Adela Leka, Drejtuese e Projektit AASF: adela.leka@aasf.com.al

Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF: ilir.pilku@aasf.com.al

Për më shumë informacion: <http://www.aasf.com.al>

REKOMANDIME

- ✓ Kultivimi i lakrës kokë për shumë prodhues është i rëndësishëm edhe për faktin se mund të mbillet në periudha të ndryshme dhe mundëson shfrytëzim më racional të tokës duke u mbjellë si para ose post kulturë. Në kuadër të kultivimit të suksesshëm të lakrës, toka (tipi, cilësia e përgatitjes së tokës), serra dhe menaxhimi i mirë i shërbimeve agro-teknike, janë faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen e bimëve dhe rendimentin e tyre.
- ✓ Paraqet një kërkesë të lartë financiare duke qenë se kërkon një nevojë likuiditeti për inpute bujqësore me rreth 1.8 milion euro për kultivimin në serra dhe rreth 4 milion euro për kultivimin në fushë të hapur.
- ✓ Kultivimi i lakrës sallatë si në fushë të hapur ashtu edhe në ambiente të mbrojtura shoqërohet me investime të domosdoshme që mund ti karakterizojmë në disa lloje:
 - Investime në mekanikë bujqësore. Aktualisht për sipërfaqen e kultivuar në fushë dhe mesatarizuar parcelat e kultivuara me rreth 2 ha/fermer parashikohet një investim në mekanikë bujqësore rreth 36 milion euro.
 - Investime në sera diellore. Sic kemi shpjeguar më lart, lakra sallatë kultivohet në rreth 400 ha sera, që për një rritje të prodhimit me 20% do të kërkohej një shtim sipërfaqe me serra me rreth 80 ha, pra një financim prej rreth 12.8 milion euro.
 - Investime në magazina grumbullimi dhe trajtimi të produktit. Lakra sallatë është produkt voluminoz dhe si i tillë kërkon investime në ambiente magazinimi dhe ruajtje frigoriferike.
- ✓ Mbajtja e shënimeve financiare dhe agroteknike në fermë është një kërkesë e kohës për dy arsye kryesore: a) Certifikimin Global Gap, b) Kreditimin nga sistemi bankar.